



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINSTRAVE**

**V E N D I M**

**Nr.408, datë 20.5.2020**

**PËR**

**MIRATIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES SË TEKSTEVE  
TË BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN,  
“KLASIKËT DYGJUHËSH” DHE “FJALOR DYGJUHËSH PËR  
FËMIJË” DHE TË KATEGORIVE QË PËRFITOJNË FALAS KOPJE  
TË TEKSTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të nenit 5, të ligjit nr.16/2018, “Për diasporën”, të shkronjës “gj”, të nenit 21, të ligjit nr.9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë” dhe në vijim të pikave 10, shkronja “dh”, dhe 19, të vendimit nr.469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e çmimeve të shitjes së teksteve të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, të serisë “Klasikët dygjuhësh” dhe “Fjalor dygjuhësh për fëmijë”, sipas listës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, me qëllim mundësimin e ruajtjes, të zhvillimit dhe të mësimin të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë.
2. Kategoritë që i përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën janë nxënësit dhe mësuesit, sipas përcaktimeve në vendimin nr.443, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”.



3. Seria “Klasikët dygjuhësh” dhe “Fjalor dygjuhësh për fëmijë”, të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, duhet të jenë të pajisura me logon e këtij institucioni.
4. Çmimet e serisë “Klasikët dygjuhësh” dhe “Fjalor dygjuhësh për fëmijë” vendosen në kopertinat përkatëse, në përputhje me listën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, në vlerën prej 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekësh, përballohen nga buxheti i miratuar për Qendrën e Botimeve për Diasporën, për vitin 2020.
6. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

MINISTRI I SHTETIT  
PËR DIASPORËN

PANDELI MAJKO



Lista nr. 1

1. Çmimin në kopertinë prej 800 lekësh për serinë (kolanën) “Klasikët dygjuhësh”.

Seria ka në përbërje 7 libra me nga 2 rrëfenja për secilin titull:

1. E bukura dhe Bisha – Ujku dhe 7 kecat;

2. Hirushja – Pinoku;

3. Libri i xhunglës – 3 derrkucët e vegjël;

4. Rosaku i shëmtuar – Kësulëkuqja;

5. Piter Pani – Bukuroshja e fjetur;

6. Sirena e vogël – Udhëtimet e Guliverit;

7. Ushtari prej plumbi – Borëbardha.

a)Klasikët dygjuhësorë shqip – italisht

b)Klasikët dygjuhësorë shqip – greqisht

c)Klasikët dygjuhësorë shqip – anglisht

d)Klasikët dygjuhësorë shqip – gjermanisht

e)Klasikët dygjuhësorë shqip – frëngjisht

2. Çmimin në kopertinë prej 1500 lekësh për librin “Fjalor dygjuhësh për fëmijë”.

- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – italisht

- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – greqisht

- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – anglisht

- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – gjermanisht

- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – turqisht

- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – frëngjisht



- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – ukrainisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – kroatisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – spanjisht